Rollman

INTERNATIONAL

ALBANIAN

MANUAL PËRDORIMI

MAKINË HEKUROSËSE ME RUL

”ROLLMAN” MP 8015 E

MODEL-80151000012 E

CE

NB 2494

И 005 20

Rollman
INTERNATIONAL

UDHËZIME TË RËNDËSISHME PËR PËRDORIM, MIRËMBAJTJE DHE SIGURI

Para se të filloni ta përdorni makinën hekurosëse me rul (në tekstin e mëtejshëm makina hekurosëse) ju lutemi që t'i lexoni me kujdes këto udhëzime për përdorimin dhe mirëmbajtjen, për t'ju shmangur aksidenteve, lëndimeve dhe dëmtimit të pajisjes.

PËRMBAJTJA

UDHËZIME TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË E MAKINËS **5**
Qëllimi i makinës hekurosëse **5**
Siguria teknike **5**
Përdorimi i makinës hekurosëse **6**
Pajisjet dhe pjesët shtesë **7**

PJESËT KRYESORE TË MAKINËS HEKUROSËSE **8**
Paneli i kontrollit i makinës hekurosëse **9**
Lëvizja e makinës hekurosëse **9**
Palosja dhe shpalosja e makinës hekurosëse **9**
Leva e sigurisë **10**

PARA PËRDORIMIT TË PARË TË MAKINËS HEKUROSËSE **11**
Kablloja furnizuese **11**
Mbulesa e rulit **11**
Përgatitja e zonës së punës *(hapësirës punuese)* **11**
Përgatitja e rrobave për hekurosje **12**
Lagështia e rrobave **12**
Klasifikimi **12**

HEKUROSJA **13**
Ndezja dhe fikja e makinës hekurosëse **13**
Rregullimi i temperaturës hekurosëse **13**
Zgjedhja e shpejtësisë së rrotullimit të rulit **14**
Procesi i hekurosjes së rrobave **14**
Shtimi i rrobave për hekurosje **15**
Heqja e futësit të rrobave **15**
Bartësi i rrobave **15**
Këshilla të përgjithshme për hekurosje **15**

PAS HEKUROSJES SË RROBAVE **16**
Fikja e makinës hekurosëse **16**
Lënia anash e makinës hekurosëse **16**

KËSHILLA PËR HEKUROSJEN E RROBAVE TË NDRYSHME **17**
Mbulesa për tavolinë **17**
Peceta, peshqira për duar dhe ngj **17**
Këllëfe dhe mbulesa **17**
Mbulesa për jastëk **17**
Këllëf për jorgana **17**
Këmishat **18**
Pantallonat **19**
Fundet **20**

PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E MAKINËS HEKUROSËSE **20**
Pastrimi i hekurit (pllakës ngrohëse) **20**
Pastrimi i trupit të makinës hekurosëse **21**
Larja dhe zëvendësimi i mbulesës së rulit **21**
Zëvendësimi i mbulesës së rulit **21**

PYETJET E PARASHTRUARA SHPESH **23**

MBËSHTETJA PAS SHITJES **24**

MBËSHTETJA "ROLLMAN" **24**

LIDHJA NË ENERGJINË ELEKTRIKE **24**

TË DHËNAT TEKNIKE TË MAKINËS HEKUROSËSE **25**

NDIHMONI PËR TË MBROJTUR NATYRËN **26**
Lënia anash e paketimit **26**
Lënia anash e makinës së vjetër hekurosëse që është përjashtuar nga përdorimi **26**

ETIKETA E LLOJIT **27**

TË DHËNAT KONTAKTUESE: **30**

UDHËZIME TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË E MAKINËS

Qëllimi i makinës hekurosëse

- Qëllimi kryesor i këtij produkti është hekurosja e të gjitha sendeve nga materialet tekstile në amvisëri, lavanderi, konvikte, restorante, hostele dhe të ngjashme, në përputhje me këtë udhëzim.
- Përdorni makinën e hekurosjes vetëm për qëllimin e paraparë, dmth. për hekurosjen e tekstileve në deklaratën e të cilave tregohet se hekurosja është e lejuar.
- Personat të cilët nuk kanë aftësi adekuate fizike dhe shëndetësore ose përvojë të përshtatshme në përdorim duhet të përdorin makinën vetëm nën mbikëqyrje dhe sipas udhëzimeve të personave të trajnuar dhe me përvojë.

Siguria teknike

- Nuk është paraparë që në makinën e hekurosjes të bëni vetë modifikime dhe riparime apo çfarëdo ndërhyrje shërbimi. Këto aktivitete mund t'i bën vetëm personeli i autorizuar i shërbimit në përputhje me rregulloret kombëtare dhe lokale mbi sigurinë dhe udhëzimet e prodhuesit "ROLLMAN" për funksionimin e shërbimit teknik për inspektimin, riparimin dhe rregullimin e pajisjes.
- Riparimet dhe punimet e tjera në makinën hekurosëse nga ana e personave të paautorizuar mund të çojnë deri në shfaqjen e ngjarjeve të padëshiruara, lëndimeve dhe deri tek dëmtimi i produktit.
- Para përdorimit të parë të makinës hekurosëse, lexoni udhëzimin dhe kontrolloni nëse ka ndonjë dëmtim të dukshëm në makinë.
- Mos e përdorni më tutje makinën hekurosëse të dëmtuar, sepse me përdorimin e një makine të tillë mund të çon deri tek lëndimet. Në këtë rast, mos e lidhni kabllon e energjisë elektrike në prizë, por telefononi shërbimin e autorizuar të prodhuesit "ROLLMAN".
- Kjo makinë hekurosëse duhet të jetë e lidhur në një prizë me tokëzim për t'u garantuar siguria elektrike, sepse vetëm në atë mënyrë mund të sigurohet tokëzimi cilësor. Në qoftë se keni ndonjë dyshim lidhur me këtë pyetje, ju lutemi kontaktoni elektricistin e autorizuar i cili mund të kontrollojë instalimet tuaja elektrike.
- Para lidhjes së makinës hekurosëse, kontrolloni që të dhënat në etiketën e llojit (të vendosura në kapakun e poshtëm të tavolinës së punës) i korrespondojnë rrjetit tuaj elektrik. Nëse nuk jeni të sigurtë, kontaktoni shërbimin e autorizuar.
- Kabllot zgjatëse nuk garantojnë furniziminin e sigurtë të makinës hekurosëse me energji elektrike!

- Prodhuesi garanton për sigurinë dhe funksionalitetin e makinës hekurosëse "ROLLMAN", vetëm nëse janë instaluar pjesë origjinale. Gjatë periudhës së garancisë, servisimi mund të bëhet vetëm nga ana e teknikut të autorizuar të shërbimit.
- Makina hekurosëse është plotësisht e ndarë nga rrjeti elektrik:
    1. Kur ndërprerësi në panelin e komandimit është fikur;
    2. Kur kablloja furnizuese shkëputet nga priza.
- Për funksionimin e duhur të makinës hekurosëse nuk duhet t'i dëmtoni, largoni ose shmangni elementët e sigurisë dhe/ose të kontrollit të makinës hekurosëse "ROLLMAN".
- Mos e përdorni makinën hekurosëse në rast se ndonjë pjesë është e dëmtuar ose e çmontuar, sepse atëherë ekziston mundësi që të vini në kontakt me pjesët nën tension dhe ato lëvizëse, të cilat mund të shkaktojnë lëndime.

Përdorimi i makinës hekurosëse

PERSONAT ME MUNGESË EKSPERIENCE OSE TË PATRAJNUAR MJAFT, MUND TË PËRDORIN PAJISJE TË KËTILLA NË QOFTË SE I'U ËSHTË SIGURUAR MBIKQYRJE OSE I'U JANË DHËNË UDHËZIME TË CILAT KANË TË BËJNË ME PËRDORIMIN E SIGURTË TË PAJISJES, SI DHE MBI RREZIQET TË CILAT RRJEDHIN NGA AJO. FËMIJËT NUK GUXOJNË TË LUAJNË ME NJË PAJISJE TË KËTILLA. PAJISJET NUK DUHET TË PASTROHEN DHE TË T'I NËNSHTROHEN MIRËMBAJTJES PËRDORUESE NGA ANA E FËMIJËVE, PA MBIKËQYRJEN E DUHUR.

Në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike gjatë hekurosjes së rrobave, menjëherë tërhiqni levën e sigurisë e cila gjendet në anën e majtë të tavolinës së punës në kapakun anësor. Hekuri (pllaka ngrohëse) do të ngritet automatikisht nga ruli, ashtu që mund t'i hiqni nga rulja rrobat që jeni duke i hekurosur në mënyrë që të shmangni mbinxehjen dhe djegjen e tyre, gjëgjësisht djegien për shkak të kontaktit të zgjatur me pllakën ngrohëse të nxehtë.

- Kur hekuri është i nxehtë, ekziston rrëziku nga djegiet:
    1. Gjatë prekjes së hekurit;
    2. Kur t'i bëni presion pedales me këmbë në bazën e makinës hekurosëse për t'ia afruar hekurin rulit dhe fillimin e punës së rulit nuk guxojnë t'ju gjenden gishtat midis hekurit të ngritur dhe rulit.
- Kurrë mos leni sende mbi hekurin e nxehtë, gjëgjësisht kapakut të hekurit, sepse ekziston rreziku nga mbinxehja dhe në rastin më të keq nga zjarri.
- Rrobat e hekurosura mund t'i vendosni përmbi bartësin e rrobave. Pas përdorimit, rivendoseni bartësin në pozicionin e tij fillestar. Sigurohuni që mos ta mbingarkoni bartësin me një sasi të madhe të rrobave të hekurosura, pasi kjo mund të shkaktojë që pajisja të bëhet e paqëndrueshme.

- Fikni makinën e hekurosjes në ndërprerës përpara se të hiqni kabllon e rrymës nga priza e murit. Gjatë nxerrjes së kabllos së rrymës, kujdesni që ta tërhiqeni atë për prizës, kurse jo për kabllos.
- Mos e vendosni kabllon e rrymës mbi kapakun e nxehtë të hekurit, pasi mund të sjellë deri tek dëmtimi i kabllos, madje edhe deri tek goditja elektrike. Për mbështjelljen e kabllos pas hekurosjes, përdorni mbajtësin rrotullues të paraparë për kabllo.

Pajisjet dhe pjesët shtesë

Për makinën hekurosëse duhet të përdoren vetëm pajisjet dhe pjesët shtesë, që janë të miratuara nga ana e prodhuesit ''ROLLMAN''.

RUANI KËTË UDHËZIM DHE PERIODIKISHT RIKUJTONI VETËN PËR UDHËZIMET DHE KUSHTET E PËRDORIMIT TË MAKINËS HEKUROSËSE.

PJESËT KRYESORE TË MAKINËS HEKUROSËSE



1. **Paneli i kontrollit**
2. **Pllaka ngrohëse për hekurosje**
3. **Rregullimi i temperaturës**
4. **Mbrojtja për gishta**
5. **Ruli me mbulesë**
6. **Futësi i rrobave për hekurosje**
7. **Bartësi i rrobave**
8. **Tavolina punuese për rrobat e hekurosura**
9. **Kablloja furnizuese**
10. **Pedala këmbe në bazën e makinës**
11. **Dorëza për palosjen/shpalosjen e makinës**
12. **Leva e sigurisë**

Paneli i kontrollit i makinës hekurosëse



1. Butoni i ndezjes dhe fikjes së makinës hekurosëse me ndriçim sinjalistik të instaluar të ndezjes
2. Treguesi i ndezjes së ngrohësve të majtë dhe të djathtë
3. Butoni rrotullues për përzgjedhjen graduale të numrit të rrotullimeve / shpejtësisë së rulit

Lëvizja e makinës hekurosëse

Për të lehtësuar lëvizjen e makinës brenda hapësirës punuese në bazën e makinës janë instaluar 4 rrota. Asnjëherë mos e zhvendosni makinën kur është në pozicionin e punës dhe kur kablloja e energjisë është në fole në mur, sepse mund të sjellë deri tek dëmtimi i kabllos furnizuese dhe deri tek përmbysja e pajisjës. Lëvizni makinën e hekurosjes vetëm kur tavolina punuese me rul gjendet në pozicionin vertikal (shih fotografinë).



Kapni makinën me një dorë për tavoline pune dhe me tjetrën për pjesën e poshtme të bashkimit (si në fotografi) dhe shtyni ose tërhiqni atë në drejtimin e dëshiruar. Gjatë lëvizjes së pajisjes shmangni qilimat dhe pragjet. Përmbi pragje anoni lehtë pajisjen drejt jush dhe shtyni atë në mënyrë që rrotat të vijnë në prag.

Palosja dhe shpalosja e makinës hekurosëse

Leva (bashkuesi) për kalimin e tavolinës së punës nga pozita vertikale në horizontale dhe anasjelltas është e vendosur në pjesën e poshtme të tavolinës së punës.



Leva e sigurisë

Leva e sigurisë përdoret për ndarjen e hekurit nga ruli në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike gjatë përdorimit.



Për ta sjellë tavolinën e punës në pozicionin horizontal, gjëgjësisht për të përgatitur pajisjen për përdorim, tërhiqni dorezën dhe ngrini tavolinën e punës në pozicionin horizontal derisa të dëgjoni një klikim i cili konfirmon se tavolina punuese është vendosur në pozicionin horizontal (shih fotografinë).



Për ta sjellë tavolinën e punës në pozicionin horizontal, gjëgjësisht për të përgatitur makinën hekurosëse për lëvizje, tërhiqni dorezën (bashkuesin) dhe shtypni tavolinën e punës derisa të arrinë në pozicionin vertikal (shih fotografinë).



PARA PËRDORIMIT TË PARË TË MAKINËS HEKUROSËSE

Kablloja furnizuese

Kablloja furnizuese është e mbështjellur dhe e varur në pjesën e prapme, nën tavolinën e punës, për shtyllës vertikale të pajisjes.



Shpështjelleni kabllon furnizuese, por ende mos e kyçni atë në prizën e murit.

Mbulesa e rulit

Së pari, kontrolloni pozicionin e butonave për rregullimin e temperaturës. Butonat duhet të jenë në pozicionin zero ("të fikura").

Pastaj kyçni kabllon furnizuese në prizë dhe shtypni butonin në pajisje. Hekuri (pllaka ngrohëse) automatikisht do të ngritet nga ruli.



Tani mund të tërhiqni mbuluesin e rulit.

Përgatitja e zonës së punës (hapësirës punuese)

Vendosni në afërsinë e pajisjes:

- Shportën me rroba që planifikoni t'i hekuroseni e cila duhet të jetë në anën e majtë të pajisjes;
- Sipërfaqja për vendosjen e rrobave të hekurosura duhet të jetë në anën e djathtë të pajisjes (p.sh. karrigë ose tavolinë e lartësisë korresponduese).

Maicat, kombinezonet, bluzat, etj, duhet të vihen në varëse menjëherë pas përfundimit të hekurosjes.

Rrobat e hekurosura mund t'i vendosni mbi bartësin e rrobave.

Nëse është e nevojshme, rrobat për hekurosje duhet të lagen para hekurosjes duke e përdorur spërkatsin e duhur.

Sipas mundësie për ulje duhet të përdoret karrigë e përshtatshme sipas lartësisë.

Makina hekurosëse duhet të vendoset në sipërfaqe horizontale në mënyrë që të mos vjen deri tek lëvizja e saj për shkak të pjerrësisë së dyshemesë.

Përgatitja e rrobave për hekurosje

Për hekurosjen e lehtë dhe të shpejtë të rrobave është shumë e rëndësishme përgatitja e duhur e rrobave të cilat dëshironi t'i hekurosni.

Para hekurosjes, rrobat për hekurosje duhet të jenë:

- Të lagështa;
- Të renditura sipas llojit të pëlhurës;
- Të vendosura dhe sipas nevojës të palosura në formë në të cilën do t'i hekurosni ato.

Lagështia e rrobave

Rrobat duhet të jetë mjaft të lagështa (rreth 20% lagështi), ashtu që në kalimin e parë përmes makinës së nxerë në temperaturën e përshtatshme, ato mund të hekurosen dhe të thahen.

Lagni rrobat ashtu siç bëni atë gjatë hekurosjes manuale. Për t'u balancuar lagështira e rrobave është e dëshirueshme që t'i lagni ato disa orë para fillimit të hekurosjes. Rrobat duhet të mbështjellen për të ruajtur lagështirën e tyre.

Nëse e përdorni makinën tharëse të rrobave, zgjidhni shkallën e tharjes së paraparë për këtë lloj makine hekurosëse.

Nëse nuk keni mjaft kohë në dispozicion për t'u përgatitur për hekurosje, rrobat mund t'i lagni me ujë të ngrohtë.

Klasifikimi

Rendisni rrobat sipas llojit të pëlhurës dhe sasisë së nxehtësisë që kërkohet për hekurosjen e tyre.

Filloni hekurosjen në një temperaturë më të ulët dhe gradualisht rrisni temperaturën e pllakës ngrohëse, varësisht nga lloji i pëlhurës i cili do të hekuroshet.

Me hekurosjen e rrobave të zbutura mund të vjen deri tek akumulimi i zbutësit në hekur, domosdoshmërisht pastroni hekurin pas hekurosjes.

Vendosni rrobat e lagura në formë si zakonisht. Gjërat e mëdha siç janë mbulesat për tavolina, shtrojat, etj. duhet të palosen përgjatë në një gjerësi e cila mund të kaloj nëpër rul.

Kini parasysh gjërat në vijim:

- Kur të përdorni një makinë të re për hekurosjen e rrobave dhe ka parregullsi në rul, ato do të rrafshohen pas disa orëve të para të përdorimit të makinës hekurosëse.
- Në rast se rrobat e ndjeshme për hekurosje nuk janë futur mirë për herë të parë nën rulin për hekurosje dhe nuk janë hekurosur mirë, atëherë përsërisni hekurosjen.
- Nëse përdorni mbulesë të re për rul, lani atë para përdorimit në temperaturë më të lartë se 60 °C.

Vrsta tkanine	Përgatitja e rrobave për hekurosje
Mëndafsh	Të mbështjellen në një leckë të lagur për t'ju shmangur gjurmëve të ujit
Najlon sintetik, poliester, etj.)	Duhet të jenë pak të lagura deri në të thatë
Lesh (p.sh. pantallona)	Shtypni atë nën një pëlhurë të lagur prej pambuku
Pambuk	Duhet të jenë pak të lagura
Këllëf	Duhet të jenë mjaft të lagura

Temperatura	Lloji i pëlhurës	Shenja në rrotë
Minimale	Perlon, najlon	●
Mesatare	Lesh, mëndafsh	●●
Maksimale	Pambuk, liri	●●●

HEKUROSJA

Ndezja dhe fikja e makinës hekurosëse

Makina hekurosëse ndizet duke e shtypur butonin kryesor me sinjalizimin ndriçues së ndezjes.



Rregullimi i temperaturës hekurosëse

Temperatura hekurosëse rregullohet nëpërmjet dy butonave rrotulluese për rregullimin e temperaturës, të cilat gjenden në kapakun e pllakës ngrohëse.

Çdo buton ka për qëllim të aktivizojë dhe të rregullojë njërin grup të ngrohësve (majtas dhe djathtas), të cilët i japin ngrohje gjysmës së duhur të hekurit (pllakës ngrohëse).

Për ndezjen e ngrohësve dhe rregullimin e punës së tyre, ju mund të zgjidhni:

- Ngrohja e vetëm gjysmës së majtë të hekurit (pllakës ngrohëse);
- Ngrohja e vetëm gjysmës së djathtë të hekurit (pllakës ngrohëse);
- Ngrohjen e tërë gjërësisë së hekurit (pllakës ngrohëse).



Temperaturën e hekurit e rregulloni në butonin rrotullues përkatës të termostatit ashtu siç është paraqitur në fotografi:

- Shenja ❙ Ngrohësit janë të fikur;
- Shenja ● Temperatura e hekurit është përafërsisht deri 95°C;
- Shenja ●● Temperatura e hekurit është përafërsisht deri 130°C;
- Shenja ●●● Temperatura e hekurit është përafërsisht deri 175°C.
- Kur butoni është në pozicionin e fundit, temperatura e hekurit është 185°C.



Kur ngrohësit janë të ndezur dhe duke e nxerë hekurin, atëherë ndezet treguesi përkatës në panelin e kontrollit.

Kur termostati fik cilindo ngrohës pasi që është arrit temperatura e caktuar e hekurit në zonën në të cilën ka të bëjë me ngrohësin, atëherë treguesi nuk ndizet.

Kur temperatura e hekurit bie nën atë të caktuar, atëherë ngrohësit do të ndizen automatikisht dhe treguesi i kontrollit do të ndizet sërish.

Zgjedhja e shpejtësisë së rrotullimit të rulit

Është e mundur te vëndosni 5 shpejtësi rulit, afersisht nga 4 në 10 rrotulime në minutë, ose nga 1,9 m/min në 4,7m/min.



Shpejtësia më e ulët e rulit mundëson hekurosjen më të lehtë të rrobave të komplikuara, siç janë këmishat dhe bluzat. Gjithashtu, më së miri është të zgjidhni shpejtësinë më të vogël të rulit kur të hekurosni gjëra të palosura më shumë herë dhe gjëra të trasha, atëherë mund të nevojitet më shumë se një kalim nëpërmjet rulit për të arritur hekurosjen e mirë dhe gjërën e thatë.

Rekomandohet të përdorni shpejtësinë më të ulët në hekurosje derisa perdoruesi të fitojë përvojë duke punuar me hekurin Rollman.

Rrobat e holla, të njëfishta, p.sh. shami, pantofla etj. mund t'i hekurosni në shpejtësi më të madhe të rulit.

Rregulloni butonin e kontrollit të shpejtësisë së rulit në shpejtësinë e dëshiruar.

Rrobat më të lagështa hekurosni në një shpejtësi më të ulët të rulit.

Procesi i hekurosjes së rrobave



Procesin e hekurosjes së rrobave e menaxhoni nëpërmjet pedales së këmbës në bazën e makinës, e cila ka tre pozicione:

- Ngritja e hekurit (pllakës ngrohëse): hiqni këmben nga pedala dhe ajo do te lëvizë ne pozicionin e sipërm;
- Shypja e rrobave për rulit: shtypni pedalen deri në fund dhe pastaj ngrini pjesën e përparme të këmbës në thembër. Hekuri (pllaka ngrohëse) i afrohet rulit dhe e bën shtypjen e rrobave për rulit. Ruli nuk rrotullohet;
- Hekurosja: shtypni pedalen deri në fund dhe fillon rrotullimi i rulit në

shpejtësinë e dëshiruar. Hekurosja bëhet gjatë kohës sa jeni duke e mbajtur pedalen e shtypur deri në fund.

Për punë rekomandohen këpucë me jastëk të butë (atlete, pantofla...) pa pjesë të forta dhe të mprehta, për t'ju shmangur dëmtimeve mekanike.

Shtimi i rrobave për hekurosje



Vendosni rrobat që dëshironi t'i hekurosni në futësin e rrobave (pllakën hyrëse), ashtu që të jetë në buzë të futësit dhe pa rrudha. Pastaj shtypni pedalen deri në fund dhe fillon rrotullimi i rulit dhe gjithmonë duke i mbajtur duart larg nga hekuri (pllaka ngrohëse, në mënyrë që skaji i rrobave për hekurosje mund të jetë i kapur me hekur (pllakën ngrohëse)). Mbajeni pedalen e shtypur përderisa të mos kalojë tërë gjatësia e rrobës për hekurosje.

Heqja e futësit të rrobave

Ju mund ta largoni futësin për hekurosjen e rrobave atëherë kur dëshironi të hekurosni rroba të cilat janë në formë rrethore, p.sh. funde.

Hiqni vidhën nga ana e majtë anësore e rulit që e mban bartësin e futësit të rrobave dhe hiqni futësin e rrobave (fotografia e mëposhtme).



Ngrini lartë futësin e rrobave nga mbajtësi në anën e djathtë të rulit dhe pastaj tërhiqeni atë drejt anës së majtë të rulit.

Ktheni vidën në vendin e vetë pas heqjes së futësit të rrobave.



Bartësi i rrobave

Rrobat e hekurosura mund t'i kaloni mbi bartësin e lëvizshëm për të shmangur rrudhjen e rrobave. Kini kujdes që të mos mbingarkoni bartësin e rrobave, pasi mund të shkaktojë që pajisja të bëhet e paqëndrueshme.

Këshilla të përgjithshme për hekurosje

Ndaleni rulin për të shmagur rrudhjen e rrobave të hekurosura tërhiqni ngadalë rrobën nga pjesa e pasme e rulit për të dalur krejtësisht nga korniza e rulit.

Nëse është e nevojshme lagni rrobën sërish me një leckë të lagur ose me ujë nga spërkatësi.

Gjithmonë përdorni tërë gjerësinë e rulit për hekurosje nëse është e mundur, përndryshe pjesët e caktuara do të thahen dhe do të humbasin elasticitetin e tyre.

Për sipërfaqe të vogla të rrobave siç janë pecetat, kaloni ato në mënyrë alternative nëpërmjet zonave të ndryshme përgjatë gjerësisë së rulit.

Rrobat me kopsa duhet të kthehen në mënyrë që kopsat të jenë kthyera drejt rulit, ashtu që gjatë hekurosjes ato mund të shtypen për shtresës elastike të mbështjellur të rulit.

Për të mbrojtur hekurin (pllakën ngrohëse) evitoni hekurosjen e rrobave të cilat janë të paqendrueshme ndaj temperaturës dhe me kopsa të mëdha dhe pjesë të tjera që nuk janë rezistente ndaj nxehtësisë.

Për të parandaluar kruarjen e sipërfaqes së hekurit (pllakës ngrohëse) nga patentat, kopsat e metalit dhe pjesët e tjera metalike në rrobat e dyanshme për hekurosje, mbuloni ato me një leckë të lagur të pambukut.

Kur jeni kah fundi i hekurosjes, ulni temperaturën ose fikni ngrohësit.

Vazhdoni hekurosjen e sipërfaqeve të vogla të rrobave në temperaturë më të ulët. Në atë mënyrë do të kurseni energji elektrike.

PAS HEKUROSJES SË RROBAVE

Fikja e makinës hekurosëse

Fikni makinën hekurosëse duke e shtypur butonin në panelin e kontrollit.

Zvogëloni temperaturën e ngrohësit në minimum.

Shkëputni kabllon furnizuese nga priza e murit.

Lënia anash e makinës hekurosëse

Nëse dëshironi ta lini anash makinen e hekurosjes për një kohë të gjatë (për më shumë ditë), atëherë:

- Lëreni që hekuri (pllaka ngrohëse) të ftohet plotësisht dhe pastaj palosni makinën duke e tërhequr dorezën (bashkuesin) dhe duke e sjellur tavolinën e punës në pozicionin vertikal;
- Mbështjellni kabllon furnizuese dhe vendosni atë në vendin e vetë;
- Vendosni një mbulëse leckë për ta mbrojtur pajisjen nga pluhuri.

KËSHILLA PËR HEKUROSJEN E RROBAVE TË NDRYSHME

Mbulesa për tavolinë

Në fillim të hekurosjes shmangni bërjen e buzës në mes të mbulesës.

Vendoseni mbulesën e tavolinës në mënyrë që skajet e majta dhe të djathta të jenë të varura mbi rulin për hekurosje, kurse pjesa e mesme e mbulesës të jetë në kapje. Hekurosni pjesën e mesme të mbulesës.



Palosni mbulesën e tavolinës në gjysmë në mënyrë që skajet të jenë të rrafshuara. Lëreni pjesën e mesme të hekurosur të mbulesës të qendron e varur në skajin e majtë të rulit, në mënyrë që të parandalohet rrudhosja e kësaj pjese të hekurosur. Kaloni skajet e palosura dhe të pahekurosura të mbulesës nëpërmjet hekurit, së pari në njërën anë dhe pastaj në anën tjetër.



Peceta, peshqira për duar dhe ngj

Shtrini rrobat për hekurosje në një sipërfaqe të mjaftueshme të përlurës në futës. Kjo do të parandalojë që pëlhura të humbasë formën e saj dhe do të lehtëson orientimin e saj. Kaloni rrobat për hekurosje në mënyrë diagonale ndërmjet rulit dhe hekurit (pllakës ngrohëse) dhe mbajeni atë nëse është e nevojshme, kurse pastaj përsëritni procedurën.

Përdorni tërë gjërësinë e rulit gjatë hekurosjes së rrobave.

Këllëfe dhe mbulesa

Këto rroba mund të hekurosen në të njëjtën mënyrë si mbulesat për tavolinë ose, në qoftë se gjatësia e tyre është e pranueshme, palosni rrobat në gjysmë të gjatësisë dhe pastaj hekurosni ato në të dy anët.

Në qoftë se në rroba ka dekorata, qëndisje dhe ngjashëm, atëherë hekurosni atë duke e kaluar së pari në njërin drejtim, ndërsa pastaj përsërisni hekurosjen në drejtimin tjetër.

Mbulesa për jastëk

Vendoseni mbulesën e jastëkut në futës, vendoseni atë nën hekur (pllakën ngrohëse) dhe hekuroseni atë në një hap. Nëse në fund të hapur të mbulesës së jastëkut ka kopsa, drejtoni ato kah ruli.

Këllëf për jorgana

Nëse këllëfi i jorganit në fund të hapur ka kopsa, së pari hekuroseni atë fund.

Vërejtje:
Drejtoni kopsat kah ruli.



Filloni hekurosjen e rrobave duke e orientuar me kujdes këllëfin nëpërmjet fundit të majtë të rulit, duke u kujdesur që të mos dëmtoni asnjë kopsë.



Nëse dëshironi të hekurosni këllëf pa qepje, atëherë më së miri do të ishte që ta kaloni atë në njërën, pastaj edhe në tjetrën anë.



Nëse dëshironi të hekurosni këllëf me qepje, atëherë palosni atë në gjysmë të gjatësisë dhe hekuroseni në të dy anët.

Këmishat

Largoni futësin para fillimit të hekurosjes së këmishës.

Pjesa e shpatullave të këmishës: Së pari hekurosni pjesën e shpatullave të këmishës duke e kaluar atë në skajin e majtë të rulit, ndezni hekurin dhe tërhiqeni këmishën drejt jush.



Jaka: Pastaj hekurosni jakën duke e kaluar atë në skajin e majtë të rulit. Pastaj rrotulloni atë kah poshtë dhe butësisht shtypeni atë në pozicion të shtrënguar. Ndaleni makinën hekurosëse kur kopsat të vijnë deri tek hekuri (pllaka hekurosëse).



Pjesët e përparme të këmishës: Gjatë hekurosjes së pjesëve të përparme të këmishës vendosni vrimat për kopsa mbi pjesën e majtë të rulit, vendoseni drejt në të, me kallëp në vetë skajin e rulit. Hekurosni atë prej vrimave deri tek hapja e mëngës. Tani lëvizni këmishën dhe hekurosni atë prej hapjes së mëngës deri tek qepja anësore. Anën me kopsa hekuroseni prej brenda kah jashtë në mënyrë që kopsat të jenë pranë kapakut të rulit.



Shpina: Filloni nga kallëpët anësore. Tërhiqni këmishën në rul deri tek hapja e mëngës. Tërhiqni atë pjesë. Filloni nga skaji i rulit dhe anashkalojeni hapjen e mëngës, pastaj tërhiqeni këmishën më tej në rul dhe hekurosni tërë gjatësinë e shpinës deri tek hapja e dytë e mëngës. Tërhiqni këmishën më tej në rul dhe hekuroseni atë duke e anashkaluar hapjen e mëngës.



Kopsat dhe mëngët: Së pari, hekurosni të dy anët e kopsave në skajin e majtë të rulit. Palosni kopsat e dyfishta në mënyrë që njëra vrimë e kopsës të jetë mbi tjetrën dhe shtypni ngadalë ato. Drejtoni mëngën dhe vendoseni në skaj të rulit. Hekurosni mëngën prej fundit të kopsës deri tek sqetulla. Lëvizni atë diagonalisht për të hekurosur tërë gjerësinë e hapjes së mëngës.



Pantallonat

Hekurosja e pantallonave dhe farmerkave:

Së pari hekurosni pjesën e epërme në pjesë prej rripit deri tek këllëpi i brendshëm i pantallonave dhe farmerkave.

Përshtatni butonin për rregullimin e shpejtësisë së rulit në numër të vogël të rrotullimeve të rulit.



Hekurosni secilën këmbëz posaçërisht duke filluar nga këllëpi i poshtëm.

Shtypja e gjërave të leshta dhe e këllëpëve në rroba.



Vendosni veçmas këmbëzat e pantallonave në rul. Lini që pjesa e sipërme e pantallonave të qendron e varur mbi krahun e majtë të rulit.

Mbuloni këmbëzën me një leckë të lagësht dhe pastaj rrotulloni rulin me dorë në mënyrë që pjesa mbi të cilën keni vendosur lecka e lagësht të jetë e shtypur me hekur (pllakën ngrohëse). Shtypni me hekur (pllakën ngrohëse) secilën këmbëz në të dy anët duke filluar nga pjesa e poshtme e këmbëzës.

Fundet

Fundet do t'i hekurosni më së miri pa futësin.

Tërhiqni pjesën e poshtme të fundit në rul, ashtu që rripi të jetë pranë skajit të majtë të rulit.

Vendosni leckën e lagësht në një pjesë të fundit. Hekurosni pjesët e fundit me rend.

PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E MAKINËS HEKUROSËSE

FIKNI HEKURIN DHE SHKËPUTNI KABLLON FURNIZUESE NGA PRIZA E MURIT PARA KRYERJES SË ÇFARËDO AKTIVITETIT PASTRUES DHE MIRËMBAJTËS

Pastrimi i hekurit
(pllakës ngrohëse)

Kontrolloni ngrohësit nëse janë të fikur.

Prisni që hekuri (pllaka ngrohëse) të ftohet.

Ndani hekurin (pllakën ngrohëse) nga ruli për të qenë në mundësi për t'ju afruar sipërfaqes së brendshme sferike të hekurit (pllakës ngrohëse).

Pastrimin e hekurit (pllakës ngrohëse), gjëgjësisht largimin e shtresave të shkaktuara nga zbutësi apo gëlqera nga rrobat e lagështa e bëni duke përdorur agjente pastruese jo-abrazive për amvisëri (pasta për duar ose pasta për dhëmbë).

Shmangni spërkatjen e hekurit (pllakës ngrohëse) me sprej.

Mos përdorni agjente abrazive për pastrim.

Përdorni leckë pambuku ose prej liri. Vendosni hekurin në temperaturen më të lartë. Kaloni disa herë leckën nëpër makinë sikur te hekurosja.Papastërtitë e hekurit do të mbahen ne lecken e cilën mund ta lani dhe përdorni gjatë pastrimit të ardhsëm. Rasti më i zakonshëm i papastërtive ngrohëse janë aplikimet plastike në bluza që

duhet të mbrohet me një leckë ose aplikimi të ktehet te rulit.

Pastrimi i trupit të makinës hekurosëse

Varësisht nga papastërtia e trupit të makinës hekurosëse, pastrimin e bëni me një leckë të thatë ose të lagur.

Mos përdorni agjente abrazive për pastrim.

Larja dhe zëvendësimi i mbulesës së rulit

Është normale që gjatë hekurosjes mbulesa e rulit të kthehet në ngjyrë kafe (të zhytet).

Mbulesa e rulit mund të lahet në temperaturë prej 60 0C.

Kur mbulesa të hargjohet ose dëmtohet, ajo mund të zëvendësohet lehtë.

Mbulesa e re e rulit si një pjesë rezervë mund të gjendet tek prodhuesi i makinës hekurosëse.

Zëvendësimi i mbulesës së rulit

ZËVENDËSIMI I MBULESËS SË RULIT DUHET TË BËHET VETËM KUR HEKURI I MAKINËS (PLLAKA NGROHËSE) ËSHTË I FTOHËT.

Kur makina është e fikur, hekuri (pllaka ngrohëse) është e ndarë nga ruli.

- Fikni ngrohësit në mënyrë që butonat e kontrollit të temperaturës të vendosen në pozicionin 0.
- Largoni futësin e rrobave.
- Hiqni kapaku anësore nga ana e majtë të rulit.
- Lëshoni mbulesën e vjetër të rulit në të dyja skajet e rulit.
- Lironi dhe hiqni mbulesën e vjetër të rulit.



Futni skajin më të shkurtër të mbulesës së rulit me lidhjen e mbulesës së rulit në mënyrë që qepjet anësore të jenë nga brenda (me kokë poshtë). Lini lidhjet anësore të varura lirshëm dhe rrafshë.



- Rrafshoni skajin më të shkurtër të mbulesës së re të rulit me lidhjen e mbulesës së rulit në mënyrë që qepjet anësore të jenë nga brenda.
- Lini lidhjet anësore të varura lirshëm.
- Shtypni me këmbë pedalen në bazën e makinës për të filluar ruli të rrotullohet. Mos lejoni që shiritat të arrijnë nën mbulesë gjatë rrotullimit
- Pasi që ruli rrotullohet tre ose katër qarqe dhe fundi i mbulesës së rulit arrinë nën hekurin (pllakën ngrohëse):

- Fikni makinën dhe ende mbani pedalen në bazën e makinës të shtypur me këmbë.
- Mbulesa e rulit mbahet fortë në pozicionin në të cilin është shtypur nga ana e hekurit (pllakës ngrohëse).



Kthejeni rulin me dorë në drejtimin e ngrohësit (shih shigjetën) derisa dhëmbëzi të gjendet në pjesën e poshtme të rulit.



Ndizni makinën hekurosëse.

Shtrëngoni shiritat në anët e majtë dhe të djathtë të rulit, lidhni dhe fusni ato nën rul.



Vendosni futësin e rrobave për hekurosje në vendin e vetë.

Ndizni makinën hekurosëse – hekuri (pllaka ngrohëse) do të ndahet nga ruli.

PYETJET E PARASHTRUARA SHPESH

RIPARIMET NË MAKINËN HEKUROSËSE DUHET TË BËHEN VETËM NGA SHËRBIMET E AUTORIZUARA NË PËRPUTHJE ME RREGULLAT DHE LIGJET LOKALE DHE KOMBËTARE. RIPARIMET NGA ANA E SHËRBIMEVE TË PAAUTORIZIUARA MUND TË SHKAKTOJNË LËNDIME DHE DËMTIMIN E MAKINËS HEKUROSËSE.

1.
Makina e hekurosjes nuk ndizet

Gabimi i mundshëm: Makina hekurosëse nuk ka furnizim me energji elektrike.

Zgjidhja e problemit: Të kontrollohet ndërprerësi në hekur, kabllo i rrjetit, tensioni në prizë dhe siguresa në rrjet. Pastaj makina e hekurosjes të ndizet sërish.

2.
Hekurosja nuk është e kënaqshme

Gabimi i mundshëm: Mbulesa e rulit e zhytur ose e dëmtuar.

Zgjidhja e problemit: Të lahet mbulesa e rulit nganjëherë në 60 0C dhe për hekurosje të mirë duhet të jetë mirë e shtrënguar. Mbulesa e dëmtuar të zëvendësohet me mbulesë të re. Shihni përshkrimin „Larja ose zëvendësimi i mbulesës së rulit"

Gabimi i mundshëm: Hekuri (pllaka ngrohëse) është i zhytur, ka shtresa gëlqere dhe zbardhuesi rrobash.

Zgjidhja e problemit: Pastroni hekurin (pllakën ngrohëse) me agjent jo-abraziv për pastrim në amvisëri ose me agjent për larjen e enëve.

3.
Dridhja e rulit

Gabimi i mundshëm: Rul dridhët kur pëlhura është shumë e lagur dhe temperature e nxehtësise nuk është mjaft e lartë ose kur ka një pjesë sintetike në përbërjen e pëlhures së saj dhe hekuri është shumë I nxehtë dhe pëlhura ngjitet.

Zgjidhja e problemit: Në rastin e pare prisni që ngrohësi të nxehet ne temperature e duhur dhe më pas vayhdoni procesin e hekurosjes, kur në rastin e dytë është e nevojshme të hiqni pëlhuren, të ulni temeraturen ose të pastroni hekurin. Në rast se hekuri është I papastër, ndiqni procedurën e pastrimit të hekurit duke lëshuar pëlhurën e paster të lirit siç përshruhet më pare.

MBËSHTETJA PAS SHITJES

NË RAST TË SHFAQJES SË ÇFARËDO PROBLEMIT LIDHUR ME PAJISJEN KONTAKTONI SEKTORIN TEKNIK TË PRODHUESIT "ROLLMAN".

Kur të kontaktoni sektorin Teknik, ju lutemi sigurohuni që domosdoshmërisht të specifikoni Modelin dhe numrin Serial të makinës suaj të hekurosjes. Të dy këto të dhëna gjenden në etiketën e Llojit me të dhënat e makinës e cila gjendet në kapakun e tavolinës punuese së makinës hekurosëse.

Lloji	MP 8015 E
Modeli	80151000012 E
Numri fabrikal	GGMMXXXX
Tensioni/Frekuenca	230 V AC 50 Hz
Fuqia e siguresës	16 A
Fuqia	2400 W
Fuqia e motorit elektr.	0,06 kW

MBËSHTETJA „ROLLMAN"

Gjatë blerjes së makinës hekurosëse kërkoni nga shitësi që t'ju vërteton kartën e garancisë.

Periudha e garancisë për makinën hekurosëse të blerë tek shitësi i autorizuar zgjat dy (2) vjet nga data e shitjes.

Gjatë kësaj periudhe, prodhuesi i makinës hekurosëse "ROLLMAN" do të eliminojë të gjitha problemet dhe mangësitë në makinë, të cilat nuk janë të shkaktuara për shkak të përdorimit joadekuat të makinës.

Gjatë riparimeve të makinës kërkoni vetëm instalimin e pjesëve rezervë origjinale, sepse instalimi i tyre ju ofron siguri, besueshmëri dhe jetëgjatësi të makinës suaj.

Për më shumë detaje rreth mundësive për servisimin e makinës, rreth rrjetit të shërbimit dhe kontakteve, të njëjtat mund t'i gjeni në kartën e garancisë.

LIDHJA NË ENERGJINË ELEKTRIKE

Makina hekurosëse është paraparë që të lidhet në prizë të instaluar siç duhet me kontakt mbrojtës të tensionit AC 220-240 V, 50 Hz.

Fuqia e lidhjes dhe fuqia e siguresës janë të specifikuara në pllakën me shënime (siguresa 16 A). VDE rregulloret në direktivën DIN VDE 0100, pjesa 739 - prodhuesi këshillon që pajisja të lidhet nëpërmjet siguresës FI me siguresë ndërprepëse prej 30 mA (DIN VDE 0664).

Mos bëni riparime në kabllon furnizuese dhe në spinë.

Të gjitha punët elektrike në makinën e hekurosjes duhet të kryhen nga ana e elektricistëve të kualifikuar në përputhje me rregulloret lokale dhe kombëtare.

Mos e lidhni makinën hekurosëse në rrjet elektrik nëpërmjet kabllos zgjatëse. Kablloja zgjatjese nuk garanton sigurinë e nevojshme të makinës hekurosëse për shkak të mbinxehjes së mundshme të kabllos zgjatëse.

KUJDES: **PAJISJA DUHET TË JETË E TOKËZUAR.**

TË DHËNAT TEKNIKE TË MAKINËS HEKUROSËSE

Karakteristika	Vlera/përshkrimi
Përmasat në pozicionin e punës	Gjatësia: 985 mm Gjërësia: 450 mm Lartësia: 1000 mm
Përmasat në pozicionin e palosur	Gjatësia: 585 mm Gjërësia: 450 mm Lartësia: 1070 mm
Pesha	45 kg
Gjatësia e rulit dhe hekurit	800 mm
Diametri i rulit	150 mm
Numri i rrotullimeve të rulit	4-10 rrotullume/min
Temperatura e punës së hekurit	0-185°C
Temperatura maksimale e hukurit	205°C, është e kufizuar nga 2 termondërprerës sigurie
Zonat e ngrohjes së hekurit	Gjysma e majtë, gjysma e djathtë, tërë gjatësia e hekurit
Shtypja e hekurit për rulit	Arrihet nëpërmjet levës me një spiralë me fuqi të rregullueshme
Lidhja elektrike	230V AC, 50 Hz, priza me tokëzim
Lloji dhe numri i ngrohësit	Ngrohës në formë shufre 4 copë
Fuqia nominale e instaluar	Model 80151000012 E - 2500 W
Fuqia e ngrohësit	Model 80151000012 E - 4x0,6kW
Tensioni komandues	24 V DC, sigurohet nëpërmjet transformatorit dhe ndreqësit
Motori për rrotullimin e rulit	24 V DC, i fuqisë 60 W
Motori për afrimin e hekurit për rulit	24 V DC, i fuqisë 60 W
Siguresa	16 A

NDIHMONI PËR TË MBROJTUR NATYRËN

Lënia anash e paketimit

Stiropori i aplikuar në paketim është i riciklueshëm. Ju lutemi dorëzoni atë për riciklimin.

Të gjitha pjesët plastike (shiritat, qeset, etj.) mbajini larg fëmijëve, pasi mund të mbyten nga ato.

Lënia anash e makinës së vjetër hekurosëse që është përjashtuar nga përdorimi

Makinat për hekurosje përmbajnë shumicën e materialeve të riciklueshme.

Ju lutemi kontaktoni kolektorin Tuaj lokal të lëndëve të para sekondare dhe pajisjeve të vjetra elektrike dhe pyesni për mënyrën dhe kushtet e marrjes së makinës suaj të vjetër.

Para dorëzimit të makinës së vjetër hekurosëse përgatiteni atë për transport ashtu siç është theksuar në kapitullin "Zhvendosja dhe lëvizja e makinës hekurosëse".

ETIKETA E LLOJIT



Rollman
INTERNATIONAL

TË DHËNAT KONTAKTUESE:

Rollman sh.p.k.
Beograd-Stari Grad,
Kneza Mihaila 9, 11000 Serbi
NIT: 108440729
nr. identifikues: 21000272
tel: +381 11 322 33 66

Shërb. qendror:
ROLLMAN sh.p.k.
BEOGRAD DEGA ROLLMAN NISH
Bulevar Svetog cara Konstantina 80-82, 18000 Niš
tel: +381 18 550 501

8607000188206

CE
NB 2494 И 005 20